



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 179 prot.

Tiranë më 26. 1.2021

VENDIM

Nr. 02, datë 26. 1.2021

PËR KONTROLLUESIN "VODAFONE ALBANIA" SHA

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar (në vijim, "*Ligji*"), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" (në vijim, "*Kodi i Procedurave Administrative*"), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Vodafone Albania*" SHA (në vijim, "*Kontrolluesi*"),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 140, datë 03.09.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, "*Komisioneri*"), u krye hetim administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar dhe akteve nënligjore të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, konstaton se:

1. Kontrolluesi kryen fushata marketingu nëpërmjet thirrjeve telefonike drejtuar klientëve Vodafone dhe jo-Vodafone.

Për klientët jo-Vodafone, marketingu ka për qëllim informimin mbi produktet, shërbimet dhe promocionet më të fundit të Vodafone. Të dhënat për këtë kategori

subjektsh të dhënash sigurohen nëpërmjet gjenerimit të rastësishëm, nëpërmjet një pajisjeje elektronike, të numrave telefonikë 12 shifrorë, të cilët nuk janë klientë të Kontrolluesit.

Lista e gjeneruar e numrave vendoset në një program (*shared folder*), ku aksesohet nga punonjësit e *call center* të angazhuar nga Kontrolluesi dhe më pas, klientët telefonohen për t'u informuar mbi produktet dhe ofertat më të reja.

Kontrolluesi kryen marketing të drejtpërdrejtë ndaj subjekteve të të dhënave personale, që nuk janë klientë të tij dhe që nuk kanë dhënë pëlqimin për përpunimin e të dhënave të tyre.

Për thirrjet me qëllim marketingu drejt subjekteve të të dhënave personale, të cilët nuk janë klientë të Kontrolluesit, janë përdorur 291 (dyqind e nëntëdhjetë e një) numra të Kontrolluesit. Fushata informuese e ndërmarrë nga Kontrolluesi, për ofertat e portabilitetit, ka filluar në fund të muajit Korrik dhe ka vijuar. Nga punonjësit e *call center* janë kryer mesatarisht 1 000 (një mijë) telefonata në ditë.

Zyra e Komisionerit vlerëson se përpunimi i të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, të cilët nuk kanë dhënë pëlqimin për përpunimin e të dhënave të tyre për qëllime marketingu, pavarësisht mënyrës së gjenerimit të të dhënave personale (në këtë rast numrat e telefonit), është në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë së përpunimit sanksionuar në germën "a" të pikës 1 të nenit 5 dhe me kriterin ligjor të përpunimit sanksionuar në germën "a" të pikës 1 të nenit 6 të Ligjit.

Ekzistenca e pëlqimit në këtë rast është e vetmja mundësi ligjore e Kontrolluesit, referuar pikës 5 të nenit 6 të Ligjit, për të legjitimuar përpunimin e të dhënave personale. Pëlqimi, në bazë të nenit 3 pika 24 të Ligjit, "*duhet të jetë në formën e një deklarate me shkrim, i dhënë shprehimisht me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, çka nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënat e tij*".

Për sa kohë Kontrolluesi nuk ka mundur të provojë ekzistencën e pëlqimit, Zyra e Komisionerit vlerëson se përpunimi i të dhënave është i paligjshëm.

2. Nga verifikimi i dosjeve të personelit u konstatua se Kontrolluesi mbledh, ndër të tjera, "*fatura të ujit*" dhe "*faturës së energjisë elektrike*" të punëmarrësve.

Zyra e Komisionerit vlerëson se mbledhja e "*faturës së ujit*" dhe "*faturës së energjisë elektrike*" të punëmarrësve nga Kontrolluesi, rezulton të jetë në tejkalim të qëllimit të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave në kuadër të punësimit, në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale sanksionuar në germën "c" të pikës 1 të nenit 5 dhe nenin 6 të Ligjit.

3. Referuar formularëve “Kërkesë për Pajtim në rrjetin Vodafone Albania”, “Aplikim për kërkesa dhe shërbime të ndryshme” dhe “Shërbime Vodafone Logistic IOT”, konstatohet se nuk kryhet informimi i subjekteve për përpunimin e të dhënave, në përputhje me nenin 18 të Ligjit, për të cilat Kontrolluesi është përgjegjës.

Sa më sipër, subjekti i të dhënave nuk informohet në mënyrë të saktë dhe të plotë në lidhje me të gjitha kategoritë e të dhënave personale të përpunuara, cilat të dhëna personale janë të detyrueshme për tu përpunuar nga Kontrolluesi, transferimin ndërkombëtar, cilat prej të dhënave përpunohen me kërkesë të klientit (në varësi të shërbimit të kërkuar) dhe mbi të drejtat ligjore që gëzon.

Referuar gërmës “g” të pikës 8 të “Termave të përgjithshëm të ofrimit të shërbimeve...”, Kontrolluesi nuk informon qartësisht subjektet e të dhënave mbi legjislacionin specifik (ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar), por i referohet përgjithësisht legjislacionit shqiptar në fuqi.

4. Kontrolluesi disponon aplikacionin “Tirana ime”, i cili mund të shkarkohet nga përdoruesit në platformat “Play Store” dhe “App Store”.

Sa i përket këtij aplikacioni, Kontrolluesi nuk informon subjektet e të dhënave personale, të cilët instalojnë këtë aplikacion në aparatet celular personal, sipas parashikimeve të përcaktuara në nenin 18 të Ligjit, lidhur me fushën dhe qëllimin e përpunimit, kohën e ruajtjes së të dhënave, nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare, si dhe të drejtën për të kundërshtuar përpunimin e mëtejshëm të të dhënave, etj.

5. Kontrolluesi, në kuadër të disa prej shërbimeve teknike, ka kontraktuar shoqërinë “LivePerson Netherlands B.V.” (me seli në Hollandë).

Nga analizimi i “Politikës së Privatësisë” në faqen zyrtare të internetit, të Kontrolluesit, si dhe shqyrtimi i formularëve “Kërkesë për Pajtim në rrjetin Vodafone Albania”, “Aplikim për kërkesa dhe shërbime të ndryshme” dhe “Shërbime Vodafone Logistic IOT”, rezulton se subjektet e të dhënave nuk informohen për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërmbyshja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

6. Nga analizimi i kontratave të delegimit (*outsorce*), për përpunimin e të dhënave personale, rezultojnë shkelje të dispozitave të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit 19, datë 03.08.2012, të Komisionerit, mbi “*Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*” i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimit nr. 19*”).

Kontrolluesi ka deleguar disa shërbime, konkretisht:

**a. Shërbimi i arkivimit dhe shkatërrimit të dokumenteve është deleguar tek shoqëria “Marketing & Distribution” Shpk:**

Referuar pikës 3 të kontratës me shoqërinë “Marketing & Distribution” Shpk, e cila rregullon kohëzgjatjen e saj, parashikohet se kjo e fundit hyn në fuqi ose i fillon efektet ligjore që më datë 01.07.2013, si dhe se do të jetë e vlefshme për një periudhë fillestare prej 3 (tre) vitesh, vetëm nëse nuk përfundon në përputhje me parashikimet e pikës 15 të saj (*Përfundimi*). Në fund të afatit fillestar (prej 3 (tre) vitesh) kohëzgjatja mund të rinovohet me tej për një periudhë 24 (njëzet e katër) mujore nëpërmjet një marrëveshjeje të shkruar.

Zyrës së Komisionerit nuk i është vënë në dispozicion marrëveshja e zgjatjes së afatit për një periudhë 24 (njëzet e katër) mujore. Por edhe nëse kjo marrëveshje do të ekzistonte, referuar afateve të cituara më sipër, kontrata do të ishte e vlefshme deri në Gusht të 2018. Në këtë kuadër, duke filluar nga data e përfundimit të afatit të kontratës në fjalë, shoqëria “Marketing & Distribution” Shpk e humbet statusin e përpunuesit.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se vijimi i përpunimit të të dhënave nga “Marketing & Distribution” Shpk dhe përhapja, transmetimi i të dhënave nga Kontrolluesi drejt kësaj shoqërie është në kundërshtim me parimin e përpunimit të drejtë dhe të ligjshëm të të dhënave personale, parashikuar në germën “a” të pikës 1 të nenit 5 dhe nenin 20 të Ligjit.

Referuar mbikëqyrjes në ambientet e magazinimit të dosjeve të të dhënave, rezultoi se dokumentet ishin në kuti të hapura dhe jo hermetike, gjë që i mundëson lehtësisht akses në këto të dhëna personave të paautorizuar, qofshin këta punëmarrës dhe/ose palë të treta kontraktore të “Marketing & Distribution” Shpk.

Ky përpunim të dhënash është në kundërshtim me masat e sigurisë lidhur me kutitë e ruajtjes së dokumenteve arkivore, të parashikuara në pikën 4.5 të Aneksit

1 , me titull “*Specifikimet e shërbimeve*”, në rubrikën “*Specifikimet e shërbimit të arkivimit*”, të kontratës midis Kontrolluesit dhe përpunuesit.

Në këtë kuadër, kjo sjellje përbën cënim të nenit 27 lidhur me masat tekniko-organizative dhe potencialisht, shkelje të nenit 28 lidhur me aksesin eventual që palë të treta mund të kenë në të dhëna për shkak të mosrespektimit të masave tekniko-organizative sipas nenit 27.

Zyra e Komisionerit vlerëson se detyrimi për të garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale është veçanërisht i rëndësishëm, në zbatim të neneve 27 dhe 28 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Gjithashtu, në kontratë nuk parashikohet garantimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave sipas Kreut IV të Ligjit.

Në aneksin e kontratës me titull “*Minimum security requirements for personal data and information*”, në pikën 1.3, parashikohet se në këtë dokument ndryshimet janë bërë për të qenë në përputhje me kërkesat e legjislacionit spanjoll.

Nga kontrata, si dhe nga provat e tjera të vëna në dispozicion, rezulton se Kontrolluesi nuk i ka informuar subjektet e të dhënave personale lidhur me delegimin e shërbimit të ruajtjes (arkivimit) dhe shkatërrimit të dokumenteve dhe përhapjen e të dhënave personale drejt përpunuesit, në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

**b. Shërbimi i marrjes në sigurim të punonjësve përftohet nga shoqëria “Intersig-Vienna Insurance Group” SHA:**

Referuar nenit 6 të marrëveshjes me shoqërinë “*Intersig-Vienna Insurance Group*” SHA, që lidhet me kohëzgjatjen e saj, parashikohet se kjo e fundit do të jetë e vlefshme për një afat 2 (dy) vjeçar, i cili fillon më datë 30.05.2017 dhe përfundon më datë 29.05.2019. Zyrës së Komisionerit nuk i është vënë në dispozicion një marrëveshje e re me përpunuesin.

Në këtë kuadër, që nga data 29.05.2019 shoqëria “*Intersig-Vienna Insurance Group*” SHA rezulton të ketë humbur statusin e përpunuesit.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se vijimi i përpunimit të të dhënave nga “*Intersig-Vienna Insurance Group*” SHA dhe përhapja, transmetimi i të dhënave personale nga Kontrolluesi drejt kësaj shoqërie është në kundërshtim me parimin

e përpunimit të drejtë dhe të ligjshëm të të dhënave personale, parashikuar në germën “a” të pikës 1 të nenit 5 dhe nenin 20 të Ligjit.

Në kontratë nuk parashikohen masa lidhur me garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale në përputhje me Kreun IV të Ligjit.

Gjithashtu, nuk parashikohen masa lidhur me faktin se çfarë ndodh me të dhënat personale të subjekteve, pas përfundimit të marrëveshjes, në kundërshtim me germën “ç” të pikës 1 të nenit 20 të Ligjit.

Referuar pikës 5.1 të nenit 5 të marrëveshjes, nuk parashikohen afate konkrete për ruajtjen e të dhënave personale të të siguruarve, nga ana e siguruesit (“*Intersig-Vienna Insurance Group*” SHA).

**c. Shërbimi i shitjes me pakicë dhe promovimit të produkteve dhe shërbimeve të Kontrolluesit është deleguar tek dyqanet e shoqërisë “*New Development*” SHPK:**

Kontrolluesi ka nënshkruar me shoqërinë “*New Development*” SHPK, “*Marrëveshjen për përpunimin e të dhënave personale*”.

Nga dispozitat e kësaj marrëveshjeje, e cila është objekt analizimi në kuadër të hetimit dhe është vënë në dispozicion nga Kontrolluesi, rezulton se Kontrolluesi ka nënshkruar, me “*New Development*” SHPK, edhe disa marrëveshje shërbimi të cilat citohen në të, por të cilat nuk i janë vënë në dispozicion grupit të kontrollit.

Nga analizimi i marrëveshjes rezulton se, në të, nuk specifikohen masat konkrete teknike-organizative të detyrueshme për tu zbatuar nga ana e përpunuesit “*New Development*” SHPK, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale. Edhe pse në pikën 3.1.6 të nenit 3 të marrëveshjes përcaktohen se masat do merren në përputhje me përcaktimet me shkrim të Kontrolluesit, si dhe në pikën 3.6 parashikohet se përpunuesi do zbatojë standardet Vodafone Group Minimum Security Requirements, nuk rezulton që këto masa të jenë pjesë e ndonjë aneksi kontrate që e angazhon ligjërisht përpunuesin dhe i bën të detyrueshme zbatimin e tyre.

Nga verifikimi në Regjistrin e Njoftimeve pranë Zyrë së Komisionerit, rezulton se shoqëria “*New Development*” SHPK nuk e ka përmbushur detyrimin për njoftim në zbatim të nenin 21 të Ligjit.

Në zbatim të Ligjit dhe marrëveshjes, Kontrolluesi duhet të verifikonte dhe kontrollonte zbatimin e detyrimeve të përpunuesit në kuadër të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

**ç. Shërbimi shëndetësor ndaj punonjësve të Kontrolluesit kryhet nga shoqëria “Klinika e Punës” SHPK:**

Kontrolluesi nuk e ka vendosur në dispozicion marrëveshjen kryesore me përpunuesin “Klinika e Punës” SHPK (referuar si *Master Agreement*) pjesë e të cilës është edhe Aneksi 1 që parashikon të dhënat konkrete sensitive që akseson përpunuesi (referuar në Aneksin 3 të “*Marrëveshjes për Përpunimin e të Dhënave Personale*” të nënshkruar nga palët).

Referuar Aneksit 4 “*Group Minimum Security Requirements*” të “*Marrëveshjes për Përpunimin e të Dhënave Personale*” që është nënshkruar nga Kontrolluesi dhe përpunuesi (“Klinika e Punës” SHPK) konstatohet se përmban rregulla standarde që nuk reflektojnë specifikat e procesit konkret të përpunimit që kryhet nga përpunuesi, rregulla që nuk përputhen me kategorinë specifike të të dhënave që përpunohen (të cilat në rastin konkret janë të dhëna shëndetësore, pra sensitive në kuptim të nenit 7 të Ligjit) dhe qëllimin e përpunimit (specifikuar edhe në aneksin 3 “*Occupational Health Services*”).

Gjithashtu, edhe në rregullat që referohen për të dhënat sensitive (*High security measures*) nuk reflekton masat e marra në përputhje me specifikat e përpunimit (fizik të kartelave shëndetësore) dhe ruajtjes së të dhënave sensitive në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 49 datë 02.03.2020 për “*Mbrojtjen e të dhënave personale shëndetësore*” (në vijim, “*Udhëzimi nr. 49*”).

Nga marrëveshja, si dhe nga provat e tjera të vëna në dispozicion, rezulton se Kontrolluesi nuk i ka informuar subjektet e të dhënave personale lidhur me delegimin e shërbimit shëndetësor dhe përhapjen e të dhënave sensitive drejt përpunuesit, në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 49.

Nga verifikimi në Regjistrin e Njoftimeve, rezulton se shoqëria “Klinika e Punës” SHPK e ka përmbushur detyrimin për njoftim, në zbatim të nenin 21 të Ligjit, më datë 08.12.2020, pra pas dorëzimit të procesverbalit të hetimit i cili mban datën 27.11.2020.

Në zbatim të Ligjit dhe marrëveshjes, Kontrolluesi duhet të verifikonte dhe kontrollonte zbatimin e detyrimeve të përpunuesit në kuadër të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

**d. Shërbimi postar ndaj Kontrolluesit kryhet nga shoqëria “T.N.T Express Albania” SHPK:**

Kontrolluesi nuk ka vendosur në dispozicion të Zyrës së Komisionerit marrëveshjen kryesore me përpunuesin (referuar si *Master Agreement*), por vetëm “*Marrëveshjes për Përpunimin e të Dhënave Personale*” të nënshkruar nga palët.

Zyra e Komisionerit vëren se, nga marrëveshja dhe nga provat e tjera të vëna në dispozicion, rezulton se Kontrolluesi nuk i ka informuar subjektet e të dhënave personale lidhur me delegimin e shërbimit postar dhe përhapjen e të dhënave personale drejt përpunuesit, në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit e vlerëson si shumë të rëndësishme parashikimin e detyrimeve midis Kontrolluesit dhe përpunuesve, në rastet e delegimit të shërbimeve, sa i përket parashikimit të kushteve teknike dhe organizative dhe masave të sigurisë, konfidencialitetit, garantimit të drejtave të subjekteve dhe se çfarë do të ndodh me të dhënat personale të përpunuara, pas përfundimit të efekteve ligjore të kontratës.

Parashikimi dhe respektimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit dhe përpunuesit ka ndikim të drejtpërdrejtë në ligjshmërinë e përpunimit jo vetëm për proceset përpunuese që janë objekt i delegimit, por edhe në përpunimin e të dhënave personale në tërësi nga Kontrolluesi.

7. Referuar marrëveshjeve të delegimit të përpunimit të të dhënave personale, të treguara në pikën 6 më sipër, rezulton se Kontrolluesi nuk ka verifikuar plotësimin e detyrimeve nga ana e përpunuesve, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 47, datë 14.09.2018 për “*Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*” (në vijim, “*Udhëzimi nr. 47*”), Udhëzimin 19 dhe nenin 20 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se verifikimi i plotësimin të detyrimeve nga ana e përpunuesit është shumë i rëndësishëm, pasi shmang pasojat që mund të vijnë nga moszbatimi i plotë ose i pjesshëm i detyrimeve që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në proceset përpunuese që kryen Kontrolluesi dhe mund të sjellë pasoja negative të drejtpërdrejta për individët, përpunimi i të dhënave personale të të cilëve është nën përgjegjësinë e Kontrolluesit.

8. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit, rezultoi se Kontrolluesi e ka përmbushur detyrimin për njoftim për përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës.



Megjithatë, gjatë hetimit administrativ të ushtruar dhe në zbatim të pikës 1 të nenit 21 të Ligjit, konstatohet se njoftimi nuk është i plotë dhe i saktë dhe për pasojë është e nevojshme të plotësohen deklaratimet në lidhje me:

- (i) Deklarimin në rubrikën 3 “*Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen*”, sa i përket kategorive të tilla si “*Vizitorë*” (të dhënat personale të të cilëve përpunohen nëpërmjet regjistrit të hyrje-daljeve dhe sistemit CCTV), “*Klientët jo-Vodafone*” (të dhënat e të cilëve janë përpunuar për qëllime marketingu), “*Individë*” (të dhënat e të cilëve përpunohen në kuadër të komunikimit “*Live Chat*” në *Facebook* ose *WhatsApp*) që kanë pyetje mbi reklamat) dhe “*Familjarë të punonjësve të Vodafone*” (të dhënat e të cilëve përpunohen në kuadër të sigurimit të shëndetit, parashikuar në marrëveshjen për marrjen në sigurim me shoqërinë “*Intersig-Vienna Insurance Group*” SHA.

Zyra e Komisionerit vlerëson se deklarimi nuk nënkupton që përpunimi i të dhënave është i ligjshëm për këto kategori subjektësh, por evidenton gjendjen faktike dhe reale të përpunimit të të dhënave personale.

- (ii) Në varësi të kategorive të subjekteve cituar në pikën (i) më sipër lind detyrimi i përditësimit edhe të deklaratimit në Rubrikën 4 “*Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen*” dhe në Rubrikën 6 “*Qëllimi i përpunimit*”;
- (iii) Deklarimin në rubrikën 7 “*Marrësi i të dhënave personale*”, të marrësve drejt të cilëve Kontrolluesi i përhap të dhënat personale në zbatim të marrëveshjeve të bashkëpunimit/delegimit të përpunimit, të tilla si, por pa u kufizuar:
  - a. Marrëveshja me “*Marketing & Distribution*” Shpk, për delegimin e shërbimit të arkivimit dhe shkatërrimit të dokumenteve;
  - b. Marrëveshja për shërbimin postar me shoqërinë “*T.N.T Express Albania*” SHPK;
  - c. Marrëveshja me shoqërinë “*Klinika e Punës*” SHPK, për sigurimin e shërbimeve shëndetësore për punonjësit e Kontrolluesit;
  - d. Marrëveshja me shoqërinë “*New Development*” SHPK, për shitjen me pakicë dhe promovimin e produkteve dhe shërbimeve të Kontrolluesit;
  - e. Marrëveshja me “*Intersig-Vienna Insurance Group*” SHA, për marrjes në sigurim të punonjësve është deleguar te shoqëria Marrëveshja për shitjen e borxhit me tranzit;

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për përditësimin e ndryshimit të gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep Ligji.

9. Kontrolluesi, në kuadër të zbatimit të detyrimeve të parashikuara në Udhëzimin nr. 47, ka përgatitur Analizat e Ndikimit në të Dhënat Personale vetëm për aplikacionin “*My Vodafone*” dhe për aplikacionin “*Juth App*”, por jo për të gjitha proceset përpunuese që kryen dhe që janë konstatuar gjatë hetimit administrativ.

Zyra e Komisionerit thekson se Analiza e Ndikimit në të Dhënat Personale është një nga elementet e rëndësishme të sistemit të menaxhimit së sigurisë së informacionit (SMSI) parashikuar në Udhëzimin nr. 47.

Referuar “*Marrëveshjeve Standard për Përpunimin e të Dhënave Personale*”, nënshkruar nga Kontrolluesi me përpunuesit të cilëve u janë deleguar disa shërbime (proceset përpunimi), parashikohet se Kontrolluesi do të ndërmarrë “*Analiza të Ndikimit në Privatësi*” për këto procese përpunuese.

Nuk është provuar nga Kontrolluesi që të jetë kryer kjo analizë e cila është pjesë e SMSI, kjo në kundërshtim me Udhëzimin nr. 47 dhe nenin 27 të Ligjit.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se plotësimi i detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit së sigurisë së informacionit (SMSI), pjesë e të cilës është edhe Analiza e Ndikimit në të Dhënat Personale, duhet të përfshijë të gjitha proceset përpunuese që kryhen nga ana e Kontrolluesit, duke përfshirë edhe marrëveshjet e delegimit të përpunimit të të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës dhe, në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesit e Kontrolluesit janë paraqitur në seancën dëgjimore të organizuar nga Zyra e Komisionerit dhe deklaruan pretendimet e tyre në lidhje me shkeljet e konstatuara gjatë hetimit administrativ, si më poshtë:

- I. Në lidhje me fushatën e marketingut të drejtpërdrejtë nëpërmjet thirrjeve telefonike drejt subjekteve jo-Vodafone, Kontrolluesi pretendon se:
- a. Një numër 12-shifror i gjeneruar në mënyrë të rastësishme dhe i pashoqëruar me asnjë të dhënë tjetër identifikuese, nuk përbën të dhënë personale në kuptim të Ligjit;
  - b. Përpunimi i të dhënave personale për promovimin e produkteve nëpërmjet telefonatave është në përputhje me interesin legjitim të biznesit të Kontrolluesit.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se një numër telefoni, pavarësisht formës apo mënyrës së krijimit të tij ose mënyrës së sigurimit të tij nga ana e Kontrolluesit, konsiderohet, në çdo rast, e dhënë personale në referim të përkufizimit të parashikuar në pikën 1 të nenit 3 të Ligjit. Kuptimi i këtij termi, referuar përkufizimit nuk duhet parë në kuptimin e ngushtë, pasi dhe natyra e tij nuk është kufizuese, por e gjerë dhe e pakufizuar. Kjo jo pa qëllim, pasi fusha e të dhënave personale në tërësi është në zhvillim të vazhdueshëm, cka nënkupton forma të reja të dhënash personale dhe mënyrash përpunimi të tyre që në përfundim kanë një të përbashkët, subjektin e të dhënave personale (personin fizik). Ky ka qenë edhe qëllimi i ligjvënësit.

Në këtë rast problematika e konstatuar lidhet me dy aspekte, me atë të gjenerimit të numrave telefonik (për të cilët Kontrolluesi është mëse i bindur paraprakisht që janë aktivë dhe nuk i përkasin klientëve të tij) dhe krijimi i një baze të mirëfilltë të dhënash (duke patur parasysh numrin e lartë tyre), por nga ana tjetër me procesin e kontaktit telefonik me persona fizikë (të cilëve u përkasin numrat) që nuk janë klientë të kontrolluesit (gjë që është paraprakisht e qartë dhe në thelb përbën qëllimin e marketingut të drejtpërdrejtë të Kontrolluesit), për të cilët Kontrolluesi nuk ka marrë pëlqimin paraprak në formë shkresore dhe të shprehur qartë siç e parashikon Ligji.

Numri i telefonit nuk e identifikon drejtpërdrejtë një individ (subjekt i të dhënave), por një numër telefoni aktiv është i lidhur me një individ dhe e bën të identifikueshëm nëse kombinohet me të dhëna të tjera.

Referimi i Kontrolluesit në gërmën “dh” të pikës 1 të nenit 6 të Ligjit, me synimin për të legjitimuar këtë përpunim, tregon paqartësinë e Kontrolluesit mbi konceptet e këtij Ligji dhe bie ndesh me argumentin dhe pretendimin e përdorur më sipër se numrat e telefonit nuk konsiderohen të dhëna personale. Kjo pasi kriteret ligjore të përpunimit të të dhënave personale referohen vetëm në rastet kur kemi të bëjmë me të dhëna personale.

Gjithashtu, edhe tentativa për të legjitimuar përpunimin duke referuar kriterin e parashikuar në gërmën “dh” të pikës 1 të nenit 6 të Ligjit, nuk qëndron, pasi neni

duhet kuptuar në tërësinë e tij dhe jo të interpretohet i ndarë nga dispozitat e tjera. Ky përpunim nuk është i vlefshëm, pasi në këtë rast çënohet e drejta e subjektit të të dhënave për një jetë private dhe personale. Në pikën 5 të nenit 6 të Ligjit specifikohet se mbledhja e të dhënave personale për arsye të tregtimit të drejtpërdrejtë lejohet vetëm nëse subjekti ka dhënë pëlqimin e shprehur qartë. Kontrolluesi në asnjë rast nuk provon që ka marrë pëlqimin përkundrazi e evidenton faktin që është bërë përpunim pa pëlqim.

Më tej, germa “dh” e pikës 1 të nenit 6 të Ligjit parashikon se të dhënat personale përpunohen, ndër të tjera, kur përpunimi është thelbësor për mbrojtjen e interesave legjitime të kontrolluesit.

Në këto kushte, Kontrolluesi duhej të provonte që përpunimi i të dhënave për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë ka qenë thelbësor për mbrojtjen (jo ndjekjen) e interesit të tij legjitim, si dhe, gjithashtu, të provonte cënimin/rrezikun eventual ndaj të cilit ky interes legjitim mund jetë ekspozuar dhe/ose i ekspozueshëm.

Në këtë kuadër, natyrshëm lind pyetja, për mbrojtjen e cilit interesi legjitim realizimi i marketingut të drejtpërdrejtë drejtë klientëve jo-Vodafone rezulton të ketë qenë thelbësor, si dhe cili është cenimi/rreziku (real dhe/ose eventual) ndaj të cilit ky interes legjitim është ekspozuar dhe rrjedhimisht, duhet të mbrohet?

Në asnjë rast, gjatë hetimit administrativ, Kontrolluesi nuk ka arritur të provojë asnjë nga elementët që parakushtëzojnë zbatueshmërinë e germës “dh” të pikës 1 të nenit 6 të Ligjit.

- II. Në lidhje me mbledhjen e kopjes së “*faturës së ujit*” dhe “*faturës së energjisë elektrike*” të punëmarrësve, Kontrolluesi pretendon se referuar parashikimeve të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, verifikimi nga ana e punëdhënësit e adresës së saktë të banimit të punëmarrësit rezulton tepër e rëndësishme për të realizuar komunikime shkresore në raste specifike gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënieve të punës. Sa më sipër, përpunimi i këtyre të dhënave është tërësisht në përputhje me parashikimet e germës “ç” dhe “dh” të pikës 1 të nenit 6 të ligjit për shkak se bëhet për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kontrolluesit si dhe/ose për mbrojtjen e interesave legjitime të tij.

Zyra e Komisionerit vlerëson se mbledhja e “*faturës së ujit*” dhe “*faturës së energjisë elektrike*” të punëmarrësve nga Kontrolluesi, është në tejkalim të qëllimit të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave në kuadër të punësimit dhe, për pasojë, në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale sanksionuar në germën “c” të pikës 1, të nenit 5 dhe nenin 6 të Ligjit.

- III. Në lidhje me plotësimin e detyrimit për informim sipas nenit 18 të Ligjit, referuar formularëve të regjistrimit “*Kërkesë për Pajtim në rrjetin Vodafone Albania*”, “*Aplikim për kërkesa dhe shërbime të ndryshme*” dhe “*Shërbime Vodafone Logistic*”

IOT”, Kontrolluesi pretendon se nuk përmbajnë informacion të plotë për përpunimin e të dhënave personale pasi në çdo rast formularët shoqërohen me “*Termt dhe Kushtet e Përgjithshme të Pajtimit në rrjet*” ku subjekti njihet plotësisht me mënyrën e përpunimit të të dhënave personale. Nga ana tjetër, pretendohet se “*Termt dhe Kushtet e Përgjithshme të Pajtimit në rrjet*” ose ndryshe “*Kontrata e pajtimit*”, është dokument i hartuar në përputhje me kërkesat e nenit 99 të Ligjit 9918/2008, si dhe rregullave të tjera të nxjerra nga AKEP. Në pikën 8/g të termave dhe kushteve të përgjithshme bëhet referim në legjislacionin shqiptar në fuqi dhe jo specifikisht në Ligjin 9887/2008, pasi Kontrolluesi, si dhe çdo subjekt tjetër që operon në fushën e komunikimeve elektronike, përpunon të dhënat personale të pajtimtarëve jo vetëm në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, por edhe në përputhje me parashikimet e ligjit të posaçëm 9918/2008 “*Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë*” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tyre.

Zyra e Komisionerit në këtë rast vlerëson se pavarësisht parashikimeve ligjore specifike që rregullojnë sektorin e telekomunikacionit, Kontrolluesi duhet të marrë masa për të informuar plotësisht subjektet e të dhënave duke përdorur mënyra alternative dhe sa më fleksibël. Roli i AKEP dhe parashikimet në legjislacionin specifik nuk mund të përbëjnë pengesë në asnjë rast për të kufizuar ose justifikuar mos plotësimin e detyrimit për informim sipas nenit 18 të Ligjit.

- IV. Në lidhje me aplikacionin “*Tirana ime*”, Kontrolluesi, edhe pse pohon se është zhvillues dhe pronar i tij, pretendon se nuk është kontrollues, por ia ngarkon këtë rol Bashkisë Tiranë që e përdor këtë aplikacion.

Zyra e Komisionerit vlerëson se interpretimi i Kontrolluesit lidhur me termin “*Kontrollues*” është i gabuar, pasi për sa kohë e ka krijuar aplikacionin, e konsideron veten pronar të tij dhe ajo që është më e rëndësishmja ofron gjithë infrastrukturën teknologjike për kryerjen e përpunimit të të dhënave personale, atëherë kontrollues është edhe Kontrolluesi (Vodafone). Për pasojë ky subjekt, në cilësinë e kontrolluesit, ka detyrimin e për të informuar subjektet e të dhënave personale në mënyrë të plotë në zbatim të nenit 18 të Ligjit.

- V. Në lidhje me informimin e subjekteve për transferim ndërkombëtar të të dhënave drejt përpunuesit “*LivePerson Netherlands BV*”, me seli në Hollandë, Kontrolluesi pretendon se neni 18 nuk parashikon në mënyrë të shprehur detyrimin e tij për të informuar subjektet lidhur me transferimin ndërkombëtar të të dhënave të tyre personale.

Zyra e Komisionerit, vlerëson se interpretimi i Kontrolluesit është i gabuar pasi referuar dispozitës, Kontrolluesi ka detyrimin për informim të subjektit të të dhënave për çdo lloj përpunimi. Referuar nenit 3 të Ligjit, edhe transferimi

ndërkombëtar konsiderohet përpunim të dhënash personale, kjo pavarësisht nëse marrësi ndodhet në një vend me nivel të mjaftueshëm mbrojtjeje ose jo.

- VI. Në lidhje me konstatimet e Zyrës së Komisionerit sa i përket marrëveshjeve të delegimit të përpunimit të të dhënave personale me palë të treta, Kontrolluesi ka paraqitur disa pretendime.

Sa i përket pretendimeve lidhur me vlefshmërinë e marrëdhënies kontrollues-përpunues dhe humbjen e cilësisë së përpunuesit nga ana e shoqërive të kontraktuara për kryerjen e shërbimeve, Zyra e Komisionerit vlerëson se në referim të legjislacionit specifik për mbrojtjen e të dhënave personale ekzistenca e një kontrate të vlefshme është kusht për ekzistencën e marrëdhënies kontrollues-përpunues. Në këtë rast nuk diskutohen efektet juridike civile të veprimit juridik civil, por në thelb është vijueshmëria e detyrimeve lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale.

Sa i përket pretendimeve mbi zbatimin e masave të sigurisë, referuar pikës 4.5 të Aneksit 1 të kontratës së kontrolluesit me shoqërinë “Marketing & Distribution” Shpk, Zyra e Komisionerit vlerëson se është shumë e rëndësishme që Kontrolluesi dhe përpunuesi të zbatojnë me përpikmëri detyrimet kontraktore lidhur me sigurinë e të dhënave për të cilat kanë rënë dakord. Konkretisht nga verifikimi në terren (provuar edhe nga foto të administruara si prova në dosjen e hetimit administrativ) u konstatua që këto detyrime nuk ishin zbatuar edhe pse janë shumë specifike dhe të mirëpërcaktuara. Në këtë kuadër, nuk është respektuar detyrimi për të garantuar një aspekt të sigurisë fizike dhe konfidencialitetit të të dhënave personale, në kundërshtim me nenet 27 dhe 28 të Ligjit.

Gjithashtu, referuar aneksit të marrëveshjes me shoqërinë “Marketing & Distribution” Shpk, ku parashikohet se ndryshimet në këtë aneks, pra mbi kërkesat minimale të sigurisë, janë bërë për tu përshtatur me kërkesat e ligjit spanjoll mbi sigurinë, Zyra e Komisionerit vlerëson se për sa kohë përpunimi kryhet në Shqipëri është e detyrueshme që palët të zbatojnë, pikë së pari, dispozitat e legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në lidhje me informimin e subjekteve për transmetimin e të dhënave personale drejt përpunuesve, në kuadër të delegimit të përpunimit, Kontrolluesi pretendon se neni 18 nuk parashikon në mënyrë të shprehur këtë detyrim.

Zyra e Komisionerit, vlerëson se interpretimi i Kontrolluesit është i gabuar pasi referuar dispozitës, ky i fundit ka detyrimin për informim të subjektit të të dhënave për çdo lloj përpunimi. Referuar termave në nenin 3 të Ligjit, edhe përhapja ose transmetimi i të dhënave personale konsiderohet përpunim të dhënash personale.

Gjithashtu, referuar pretendimeve lidhur me parashikimin në marreveshje të masave në kuadër të garantimit të të drejtave të subjekteve të të dhënave personale, masave specifike tekniko-organizative me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale dhe se çfarë ndodh me të dhënat personale pas përfundimit të marrëveshjes, Zyra e Komisionerit vlerëson se përcaktimi i këtyre masave është një detyrim në zbatim të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit 19.

Sa i përket mosveprimit të Kontrolluesit për verifikimin e plotësisht të detyrimeve nga ana e përpunuesve, Zyra e Komisionerit vlerëson se mosrealizimi i këtij detyrimi ka sjellë si pasojë edhe mangësitë e konstatuara, duke veçuar edhe faktin që disa përpunues as nuk kishin plotësuar detyrimin bazë që është ai për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit (sipas nenit 21 të Ligjit), pa përmendur detyrimet e tjera që rrjedhin nga Ligji dhe aktet nënligjore.

- VII. Në lidhje me mangësitë në deklaratimet në formularin e njoftimit, të konstatuara në regjistrin elektronik dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit, Kontrolluesi pretendon se nuk i ka konsideruar të nevojshme ndryshimet, pasi ato nuk reflektoheshin në formular.

Në vijim, pas konstatimit në procesverbalin e hetimit, kontrolluesi, me shkresën nr.1010/4 prot, datë 17.12.2020, ka plotësuar dhe depozituar Deklaratën e Ndryshimit të Njoftimit, duke pranuar dhe evidentuar mangësitë përkatëse.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për përditësimin e ndryshimit të gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep Ligji.

- VIII. Në lidhje me pretendimet e Kontrolluesit sa i përket Analizës së Ndikimit në të Dhënat Personale, evidentojmë faktin se nga grupi i kontrollit është kërkuar vënia në dispozicion e këtij dokumenti për të gjitha proceset përpunuese, por përfaqësuesit e kontrolluesit vendosën në dispozicion vetëm për aplikacionin “*Juth app*” dhe “*My Vodafone*”, pa paraqitur argumentet e evidentuara në pretendime, që përsëri nuk e justifikojnë mungesën për sa kohë proceset përpunuese janë aktive dhe ndërkohë Analiza e Ndikimit në të Dhënat Personale, për vetë specifikat që ka duhet të ishte hartuar dhe implementuar.

Analizat e Ndikimit në të Dhënat Personale për proceset e tjera janë vendosur në dispozicion vetëm gjatë seancës dëgjimore me përfaqësuesit e Kontrolluesit.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39, pika 1, germat "a", "b", "ç", "d" dhe "dh" të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë si më poshtë:

- a) "Kontrolluesit që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me Kreun II "Përpunimi i të dhënave personale", dënohen me 15.000 deri në 500.000 lekë";
- b) "Kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë";
- ç) "Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë";
- d) "Kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë";
- dh) "Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë";

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara dhe pasojat janë serioze, përfshijnë elemente thelbësore të Ligjit, lidhur me garantimin e parimeve të përpunimi të të dhënave, të drejtave të subjekteve dhe detyrimeve në tërësi të Kontrolluesit, i cili zotëron pjesën më të madhe të tregut ku operon<sup>1</sup>. Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në mënyrën e reagimit të Kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve 5, 6, 18, 20, 21, 27, 28, 29, 30, 39 (pika 1 germat "a", "b", "ç", "d" dhe "dh") si dhe nenet 40 dhe 41 të ligjit,

### **V E N D O S A:**

1. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë, në vlerën 800 000 (tetëqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në Kreun II të Ligjit;

<sup>1</sup> AKEP – Raporti vjetor 2019, faqe 22 (<https://www.akep.al/wp-content/uploads/2020/07/RAPORT-VJETOR-AKEP-2019-PER-KUVEND.pdf>).



2. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë, në vlerën 400 000 (katërqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 18 të Ligjit;
3. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë, në vlerën 300 000 (treqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 20 të Ligjit;
4. Kontrolluesi duhet të ndalojë menjëherë formën e aplikuar për përpunimin e të dhënave personale për qëllime marketingu të drejtpërdrejtë;
5. Në vijim të detyrimit të parashikuar në pikën 4, të shkatërrojë në mënyrë të parikuperueshme të dhënat e mbledhura për subjektet e të dhënave “*klientë jo-Vodafone*”, të cilat përpunohen në kundërshtim me dispozitat e neneve 5 dhe 6 të Ligjit. Në këtë kuadër të mbajë evidenca për ndalimin e përpunimit dhe shkatërrimin;
6. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit, të ndërmarrë hapa konkrete për informimin specifik të subjekteve të të dhënave personale për proceset përpunuese sipas elementeve të evidentuar;
7. Kontrolluesi të nënshkruajë marrëveshjet e bashkëpunimit me përpunuesit (në rastet kur ka përfunduar afati i vlefshmërisë), të specifikojë detyrimet midis palëve, dhe të monitorojë në vijimësi zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në marrëveshjet me përpunuesit, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit. Gjithashtu të evidentojë se çfarë ndodh me të dhënat pas përfundimit të marrëveshjes përkatëse, nëse do të shkatërrohen ose jo dhe të mbajë evidencat përkatëse;
8. Kontrolluesi të ketë në vëmendje përditësimin e njoftimit, në rast të ndryshimit të gjendjes së përpunimit të të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit;
9. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, në përputhje me nenet 27 dhe 28 të Ligjit, duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale.  
Gjithashtu, Kontrolluesi duhet të monitorojë në vijimësi përpunuesit lidhur me zbatimin e masave teknike dhe organizative të rëna dakord midis palëve, të parashikuar në marrëveshjet e delegimit të përpunimit, me qëllim garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave personale.
10. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
  - (i) menjëherë, detyrimin e treguar në pikën 4 më sipër;
  - (ii) brenda 15 ditëve, detyrimet e treguara në pikat 5, 6, dhe 7 më sipër.

(iii) brenda 45 ditëve, detyrimin e treguar në pikën 9.

11. Gjoba paguhet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit.
12. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky vendim u shpall sot më 26.01.2021.

**KOMISIONERI**  
**Besnik Dervishi**

